


DHJETOR 2024

MANJA JEP LAJMIN E SHUMËPRITUR PËR ISH-PRONARËT NIS SHPËRNDARJA E FONDIT 30 MILIONË EURO PËR KOMPENSIMIN E 15 MIJË QYTETARËVE TË PREKUR NGA NDËRTIMET INFORMALE

Në prag të ndërrimit të viteve, Ministri i Drejtësisë, Ulsi Manja, gjatë një konference me gazetarët, ndau një lajm të rëndësishëm për ish-pronarët e prekur nga ndërtimet informale. Ministri bëri me dije se duke nisur nga data 31 dhjetor 2024 do të nisë shpërndarja e fondit prej 30 milionë euro, të akorduar nga qeveria shqiptare për Agjencinë e Trajtimit të Pronave (ATP). "Nuk mund të mija pa bashkëndarë me qytetarët një kartolinë urimi për 15,000 individë apo 5,320 familje, që duke filluar nga sot do të përfitojnë një masë kompensimi për shkak të procesit të legalizimeve" – tha Manja. Ky fond do të shpërndahet për 5,320 subjekte, ose rreth 15 mijë individë, të cilët do të marrin pjesën e mbetur prej 0% të vlerës financiare, duke pëmbushur kështu kompensimin e tyre në masën 100%, proces i realizuar për herë të parë në 14 vite aktivitet të ATP-së.



MIRATOHET NË KUVEND "LIGJI PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE"

Me 74 vota pro, Parlamenti miratoi "Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale," i pari ligj i harmonizuar plotësisht me acquis të Bashkimit Evropian. Ky është një hap i rëndësishëm për avancimin e negociatave me BE, veçanërisht për kapitullin e "Grupthemeloreve." Ministri Manja falenderon kolegët për votën pro dhe për mbështetjen ndaj përpjekjeve tona për ta afruar Shqipërinë më pranë familjes evropiane!

TAKIM KOORDINUES ME DREJTUESIT E INSTITUCIONEVE TË PAVARURA PËR GRUPKAPITULLIN "THEMELORËT"

Ministria e Drejtësisë zhvilloi një takim koordinues me drejtuesit e institucioneve të pavarura për të intensifikuar përgatitjet dhe për të çuar në një nivel të ri negociatat për grupkapitullin e parë "Themelorët". Ky kapitull, themelor për procesin e integritimit evropian, kërkon angazhim dhe koordinim të plotë ndërmjet institucioneve të pavarura të sistemit të drejtësisë dhe strukturave të tjera të pavarura. Ky takim rikonfirmoi angazhimin e përbashkët për të çuar përpara reformat dhe për të pëmbushur të gjitha detyrimet e këtij kapitulli kaq të rëndësishëm për integrimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Ministria e Drejtësisë, në rolin e saj udhëheqës dhe koordinues, mbetet e përkushtuar për të siguruar transparencë, profesionalizëm dhe një qasje të qëndrueshme për të çuar përpara këtë proces.



STANDARDIZIMI I PROFESIONIT TË PËRKTHYESVE ZYRTARË MINISTRIA E DREJTËSISË NIS SHPËRNDARJEN E CERTIFIKATAVE PROFESIONALE

Në rrugën drejt integritimit në BE, roli i përkthyesve zyrtarë është jetik për funksionimin e drejtësisë dhe harmonizimin e legjislacionit me standardet evropiane. Për të forcuar këtë profesion dhe për të garantuar një rregullim të plotë ligjor, Ministria e Drejtësisë ka nisur shpërndarjen e certifikatave profesionale për përkthyesit dhe interpretët e licencuar. Ky hap vendos standarde të reja për besueshmërinë, cilësinë dhe transparencën e shërbimeve ndaj qytetarëve.



MINISTRIA E DREJTËSISË DHE UNIVERSITETI "ALEKSANDËR XHUVANI" NËNSHKRUAJNË "MEMORANDUMI MIRËKUPTIMI"

Ministri Manja, dhe Rektoria e Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", Prof. Dr. Elvira Fetahu, nënshkruan sot një Memorandum Mirëkuptimi, i cili ka për qëllim fuqizimin e klinikave ligjore dhe krijimin e një lidhje të ngushtë mes arsimit të lartë dhe shërbimeve publike. Ky bashkëpunim është një hap i rëndësishëm në përgatitjen e studentëve të drejtësisë dhe forcimin e aksesit në shërbimet ligjore për qytetarët. Npërmjet këtij memorandumi, studentët e juridikut do të kenë mundësinë të fitojnë përvojë praktike pranë Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas, duke

kontribuar drejtpërdrejt në mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve që kërkojnë mbështetje ligjore. Ky program do t'i ndihmojë studentët të përgatiten më mirë për tregun e punës, duke aplikuar njohuritë teorike në kushte reale dhe duke ndihmuar ata që janë në nevojë për ndihmë ligjore. Kjo nismë i hap dyert e Ministrisë së Drejtësisë për brezat e ardhshëm të profesionistëve ligjorë, të cilët do të kontribuojnë në forcimin e shërbimeve cilësore dhe në avancimin e aksesit në drejtësi për të gjithë qytetarët shqiptarë, pa marrë parasysh kushteve të tyre financiare. Për qytetarët e Elbasanit, ky Memorandum Mirëkuptimi sjell një mundësi të re për të përfituar ndihmë juridike falas në Klinikën Ligjore pranë Universitetit "Aleksandër Xhuvani". Ky shërbim do t'u ofrojë atyre një qasje më të drejtpërdrejtë dhe efikase në drejtësi, duke mundësuar mbrojtjen e të drejtave të tyre në mënyrë më të shpejtë dhe më të sigurt. Në përfundim të eventit, Ministri Manja theksoi rëndësinë e këtij bashkëpunimi dhe u takua me studentët e fakultetit, ku vlerësoi angazhimin dhe përkushtimin e stafit akademik dhe profesoriatit, duke i falënderuar ata për rolin e rëndësishëm në mbajtjen e Elbasanit si një vatrë të dijes dhe një qendër të zhvillimit të arsimit të lartë në Shqipëri.

FAKULTETI I DREJTËSISË – KONFERENCA SHKENCORE NDËRKOMBËTARE CCAIEU 2024

Në kuadër të 70-vjetorit të Fakultetit të Drejtësisë të Universitetit të Tiranës, u zhvillua Konferenca Ndërkombëtare "Dialogu Multidisiplinar mbi Reformat, Zhvillimin dhe Bashkëpunimin", në bashkëpunim me Universitetin "Sapienza" të Romës dhe Universitetin e Sienës. Një platformë e shkëlqyer për të diskutuar mbi sfidat e integritimit dhe rolin e botës akademike në përsheptimin e rrugës së Shqipërisë drejt BE-së. Fakulteti i Drejtësisë i UT mbetet një kontribues i rëndësishëm me ekspertizën dhe përkushtimin e tij!

